



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2286/6 prot.

Datë 27.08.2024

V E N D I M

Nr. 1110/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 27.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK & “MF INVEST GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, me REF-07624-05-31-2024, me objekt *“Mbeshtetje Per Programin 2024 – 2026 – “Shërbime Projektimi”, i ndarë në Katër Lote, Loti 1: “Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë” me nr. REF- 07627-05-31-2024, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo*

vlerë konvertohet në 1,640,904.46 Euro, zhvilluar më datë 10.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK me NIPT 11807013M (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK.
Adresa: Rruga Dritan Hoxha, Nd. 117, Shk.2, Ap.4/2 Tiranë-Albania, Kodi postar 1023, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën përmes shërbimit postar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, me REF-07624-05-31-2024, me objekt “Mbeshtetje Per Programin 2024 – 2026 – “Shërbime Projektimi”, i ndarë në Katër Lote, **Loti 1: “Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë” me nr. REF- 07627-05-31-2024**, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,640,904.46 Euro, zhvilluar më datë 10.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 10.07.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 25.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|-------------------------------|---------------------|--------------|
| "ATELIER 4" SHPK | 166,600,000.00 lekë | kualifikuar |
| A & E ENGINEERING sh.p.k | 164,500,000.00 lekë | kualifikuar |
| ARCHISPACE | 166,666,667.00 lekë | kualifikuar |
| ARKONSTUDIO | 116,666,667.00 lekë | kualifikuar |
| "TAULANT" SHPK | 156,000,000.00 lekë | kualifikuar |
| A V E CONSULTING | 0.00 | skualifikuar |
| ARTECH GROUP | 0.00 | skualifikuar |
| C.E.C GROUP | 0.00 | skualifikuar |
| CIVIL CONS | 0.00 | skualifikuar |
| G B Civil Engineering | 0.00 | skualifikuar |
| GJEOKONSULT & CO | 165,000,000.00 lekë | kualifikuar |
| ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS | 0.00 | skualifikuar |

| | | |
|------------------------------|---------------------|--------------|
| InfraKonsult | 150,000,000.00 lekë | kualifikuar |
| INFRATECH | 0.00 | skualifikuar |
| INSTITUTI DEKLIADA – ALB | 166,666,667.00 lekë | kualifikuar |
| NET-GROUP | 152,500,000.00 lekë | kualifikuar |
| KKG PROJECT | 0.00 | skualifikuar |
| NG STRUCTURES | 166,666,667.00 lekë | kualifikuar |
| SEED CONSULTING | 153,312,000.00 lekë | kualifikuar |
| TOËER | 0.00 | skualifikuar |
| STUDIO-REBUS | 0.00 | skualifikuar |
| TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING | 160,000,000.00 lekë | kualifikuar |
| ZENIT&CO | 0.00 | skualifikuar |

II.3.1. Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

Bashkimi i operatoreve “CEC Group” & “MF Invest” pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se nuk plotësohet kriteri 2.2 i kapacitetit ekonomik dhe financiar te Dokumenteve Standarde te Tenderit si vijon: Kriteri 2.2: Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit - 166,666,667.00 leke pa TVSH). Sipas dokumenteve të paraqitura “CEC Group ” nuk e përmbush kriterin ekonomik pasi vlera më e madhe e xhiros vjetore të deklaruar për tre vitet e fundit është më e vogël se përqindja e marrë përsipër. Në bazë të përqindjes së marrë përsipër në këtë bashkim operatorësh, xhiroja vjetore duhet të ishte 133,333,333 lekë, ndërkohë që është paraqitur një vlerë më e vogël dhe per rrjedhojë bashkimi i operatorëve nuk plotëson kriterin e vendosur për xhiron vjetore. Sjellim ne vëmendje Ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik: Referuar ndryshimeve të fundit në ligjin nr. 16/2024, neni 17 parashikon shfuqizimin e nenit 50 "Shërbim konsulence". Kjo sjell në vëmendje parashikimet e nenit 88, pika 3, ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje." Sa më sipër, në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe referuar ndryshimeve ligjore të sipërpërmendura, bashkimi i operatorëve “CEC Group & MF Invest” nuk plotëson kriterin 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Për këtë arsye, skualifikohet”.

II.4. Në datën 08.08.2024, është publikuar në SPE, njoftimi i Fituesit paraprak të procedurës së prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr . 47 datë 12.08.2024.

II.5. Në datën 14.08.2024, operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK përfaqësues i bashkimi të operatorëve ekonomike “CEC GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF

INVEST GROUP” SHPK, ka paraqitur ankesë dorazi në Komisionin e Prokurimit Publik, me numër 2286 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.2286/2 prot., datë 15.08.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 2983/1 prot., datë 20.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2286/3 prot., datë 23.08.2024, me lëndë “*Mbi vendimin e KSHA*” (bashkëlidhur Vendimi datë 20.08.2024 nga KSHA), është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezultojnë, që autoriteti kontraktor e ka marrë në shqyrtim atë dhe nuk e ka pranuar ankesën e tij.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezultojnë, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përpunje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “CEC GROUP” SHPK, me nr. 2286 prot., datë 14.08.2024, të paraqitur përmes shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 10.07.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Në datën 08.08.2024, është publikuar në SPE, njoftimi i Fituesit paraprak të procedurës së prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr . 47 datë 12.08.2024.

III.1.3. Në datën 14.08.2024, operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK përfaqësues i bashkimi të operatorëve ekonomike “CEC GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK, ka paraqitur ankesë dorazi në Komisionin e Prokurimit Publik, me numër 2286 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “CEC GROUP” SHPK (përfaqësues i BOE) & “MF INVEST GROUP” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.4. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.2286/2 prot., datë 15.08.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

III.1.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 2983/1 prot., datë 20.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2286/3 prot., datë 23.08.2024, me lëndë “*Mbi vendimin e KSHA*” (bashkëlidhur Vendimi datë 20.08.2024 nga KSHA), është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, që autoriteti kontraktor e ka marrë në shqyrtim dhe nuk e ka pranuar ankesën e tij.

III.1.6. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III.1.7. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton, se urdhri i prokurimit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi mban nr. 119 dhe datën 15.04.2024.

III.1.8. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën me nr. 2286 prot., datë 14.08.2024 dorazi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor në rrugë shkresore dhe protokolluar nga AK me nr. 2983 prot., datë 14.08.2024.

III.1.9. Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 1 paragrafi i parë të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.*”

III.1.4. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe*

procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se bazuar në ndryshimet e ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të cilat gjejnë rregullim në ligjin nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” miratuar më datë 08.02.2024, botuar në fletoren zyrtare me nr. 40, me datë publikimi në fletoren zyrtare 04.03.2024, dhe hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, çdo ankesë e operatorëve ekonomikë që mban datë të urdhërit të prokurimit pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore (datë 20.03.2024), duhet dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike, si dhe materialeve në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik ankimes me nr. 2286 prot., datë 14.08.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dorazi si dhe në autoritet kontraktor në rrugë shkresore dhe protokolluar nga AK me nr. 2983 prot., datë 14.08.2024, në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 paragrafi i parë i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor në rrugë shkresore dhe protokolluar nga AK me nr. 2983 prot., datë 14.08.2024 si dhe Komisionit të Prokurimit Publik më datë 14.08.2024 dorazi, ndërkohë që bazuar në ndryshimet ligjore (hyrë në fuqi më datë 20.03.2024), bazuar në datën e urdhrit të prokurimit të procedurës (14.05.2024), ankesa me nr. 2286 prot., datë 14.08.2024, nga operatori ekonomik “CEC GROUP” SHPK, duhej dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik vetëm përmes Sistemit të Ankesave Elektronike. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor në rrugë shkresore dhe protokolluar nga AK me nr. 2983 prot., datë 14.08.2024 si dhe në Komisionin e Prokurimit Publik dorazi më datë 14.08.2024, konsiderohet e paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 pika 1 paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke mos respektuar kështu rrugën për paraqitjen e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe është

përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, jo vetëm brenda afatit të parashikuar në ligj, por edhe duke ezauruar rrugën e duhur ligjore për paraqitjen e ankesës.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën me nr. 2286 prot., datë 14.08.2024, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në KPP dorazi dhe autoritet kontraktor në rrugë shkresore dhe protokolluar nga AK me nr. 2983 prot., datë 14.08.2024, ky i fundit nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e rrugës ligjore, për paraqitjen e ankesës sipas parashikimeve të nenit 111, pika 1, paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve të ankimit dhe i rrugës për paraqitjen e ankesës pas ndryshimeve ligjore është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më sipër, ankesa me nr.2286 prot., datë 14.08.2024, e operatorit ekonomik “CEC GROUP” SHPK, e paraqitur dorazi, nuk pranohet.

III.2. Lidhur me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “CEC GROUP” SHPK, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje, nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit, si dhe ezaurimi i rrugës së duhur ligjore për paraqitjen e ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga

neni 111 i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar për procedurat që mbajnë datën e urdhrimit të prokurimit pas datës 20.03.2024, rregullon të drejtën e personave të interesuar në këtë procedurë, për të paraqitur ankesë vetëm përmes sistemit të ankesave elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure. Procedura para autoritetit kontraktor, si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, njëra prej të cilave është edhe paraqitja e saj vetëm përmes sistemit të ankesave elektronike për procedurat që kanë urdhrë prokurimi pas datës 20.03.2024. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave, në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë, e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit, duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe referuar ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA (datë 20.08.2024) për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “CEC GROUP” SHPK, është në kundërshtim të plotë me aktet ligjore në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “CEC GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, me REF-07624-05-31-2024, me objekt “Mbeshtetje Per Programin 2024 – 2026 – “Shërbime Projektimi”, i ndarë në Katër Lote, **Loti 1: “Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe**

fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë” me nr. REF- 07627-05-31-2024, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,640,904.46 Euro, zhvilluar më datë 10.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KSHA për trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “CEC GROUP” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

